



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, lidhur me nenin 17 (Ligji nr.03/L-087, datë:13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111(nenit 9 dhe 13) datë:20.04.2012; me tej ne tekst: Ligji nr. 03/L-087) dhe vendimit të datës 07.12.2022 nr.prot. 01-4976-22, Bordi i Drejtoreve të TK SH.A, **ri-shpallë:**

## KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës:

### Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit

Vendi: Prishtinë

Ndërmarrja: Telekom i Kosovës Sh. A

Grada: G-17

Afati i fundit për aplikim : 17.01.2023

### **Titulli i punës: Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit**

Duke i raportuar Bordit të Drejtoreve, Zyrtari Kryesor i Financave dhe Thesarit është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të Financave dhe Thesarit në TK.

Bordi i Drejtoreve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë sipas nenit 21 pikës 3 të ligjit bazik për Ndërmarrje Publike nr.03/L-087 ,gjithashtu bazuar **nenit 13** të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotesimin e nenit 21, paragrafi 21.4. të ligjit bazik, riformulohet si në vijim : të jenë persona me integritet të njojur të cilët :

- (i) i plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1(ligjit bazik),
- (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2(ligjit bazik) pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l),
- (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtore të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe
- (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

### **Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e ZKFTH janë:**

Zyrtari kryesor financiar është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve financiare të subjektit të sektorit publik për garantimin e cilësisë dhe pajtueshmërisë së:

- Dokumentit final të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të planifikimit të ndërmarrjes;
- Raporteve periodike për monitorimin e buxhetit për vendimmarrësit;
- Transaksioneve financiare, kontabilitetit dhe pasqyrave vjetore financiare të ndërmarrjes në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet nënligjore të miratuar nga Ministri i Financave;
- Rregulloreve të brendshme të menaxhimit financiar, hartimit të proceseve dhe fushat me rrezik, duke siguruar gjurmët e auditimit për të gjitha proceset në kuadër të subjektit dhe listat për kontroll financiar për të gjithë personelin e financave të ndërmarrjes.

Gjithashtu:

- Udhëheqë evidencat lidhur me mjetet financiare te Korporatës dhe gjendjen e Thesarit;
- Themelon dhe shqyrton kontrollin e brendshëm financiarë, duke përfshirë edhe blerjet, faturat e parave kesh dhe asetet fiks;

- Monitoron llogaritë fitimprurëse dhe koordinon pagesat e faturave dhe blerjeve të posaçme;
- Përgatit dokumentet e Korporatës për auditimin në fund të vitit dhe shërben si një ndërlidhës për auditorët;
- Shqyrton, marrëveshje financiare dhe mirëmban të gjitha politikat e financiare të lidhura me biznesin;
- Zhvillon dhe implementon strategjitet financiare afat mesme dhe afat gjate për të siguruar menaxhim dhe siguri të fondeve në mënyrën më profitabile;
- Inicion ndryshime dhe plane për zhvillimin e stafit në departamentin e financave në pajtim me praktikat moderne ekzistuese në këtë fushë;
- Zhvillon procedurat për të kontrolluar dhe planifikuar qarkullimin e parave;
- Siguron që TK SH.A është në pajtim me legjislacionin dhe rregulloret relevante ne këtë fushë.

Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit është në vartësi të drejtpërdrejtë dhe llogaridhëns ndaj Kryeshefit Ekzekutiv për operacionet financiare, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të ndërmarrjes.

#### Mandati i ZKFTH

- ZKTHF emërohet nga Bordi i Drejtorëve me kontratë të rregullt pune me kohëzgjatje 3 vite.

#### Kompensimi i pagës mujore

- Paga e ZKTHF është e përcaktuar me deklaratën e politikës për kompensim të zyrtarëve të lartë brenda ndërmarrjes publike Telekomi i Kosovës Sh. A

#### **Kushtet dhe kriteret që ZKFTH duhet t'i plotësoj:**

- Kandidati duhet te ketë diplomë universitare nga Fakulteti Ekonomik (programet: Banka dhe Financa, Menaxhment, Marketing, Ekonomiks dhe Kontabilitet). Diplomat duhet të jenë nga një universitet i akredituar i Kosovës ose të jenë të nostrifikuara nga MASHT.
- Të jetë Kontabilist i Certifikuar nga Ministria e Financave ose nga institucione të tjera përkatëse ndërkombëtare ose vendore në përputhje me kriteret e lëshuara nga Ministri i Financave
- Të jetë shtetas i Kosovës
- Përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
- Të dëshmoj njohuri të duhura për menaxhimin financier të ndërmarrjes.
- Aftësi për analizimin dhe detektimin e çështjeve të rëndësishme financiare;
- Njohuri të gjerë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS), menaxhim të financave dhe qarkullimit të parave;
- Kapacitet për të trajnuar dhe zhvilluar stafin e financave;
- Aftësi të forta bindëse/ndër personale;
- Zotësi për t'u përshtatur në situata të pa-planifikuar, apo të ndryshuar, fleksibilitet të planeve dhe masat për t'u përballur me rrethanat e tillë;
- Zotësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Pavarësia dhe niveli i lartë i integritetit përgjatë aktiviteteve në korporatë.
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të TK Sh. A, si dhe aftësia për të marrë vendime të rëndësishme në situatat e vështira;
- Preferohet njohuri e mirë e gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur.
- Kandidati duhet te jetë i/e lirë nga çdo konflikt interesit siç përcaktohet me Ligjin për Konfliktin e Interesit 06/L-011

Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në menaxhimin e financave. Preferohen individët me përvojë pune në ndërmarrje/ korporata me madhësi dhe kompleksitet te lartë.

Aplikacionet dhe të gjitha dokumentet mbështetëse duhet të dërgohen të shkruara ne njëren prej gjuhëve zyrtare ne Republikën e Kosovës. Formularët për aplikim mund të merren online në [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com).

Kërkesa për punësim se bashku me CV të detajuar (e cila duhet të specifikojë titullin e punës, nivelin, numrin e të raportuarëve, përgjegjësitë financiare dhe datat e sakta, për çdo pozitë të mbajtur), letër motivuese, kopja e letërnjoftimit apo pasaportës, dëshmi punësimi për çdo pozicion të mbajtur me data të sakta, dëshminë e kualifikimit (të nostrifikuara, nëse kërkohet) dhe certifikata nga gjykata kompetente për mosqenie nen hetime jo me e vjetër se 6 muaj duhet të dorëzohen personalisht ne zarf të myllur ne zyrën e arkives qendrore katër VI, zyra nr.603. Ndërtesa Kryesore e TK Dardania pa nr. 10000 Prishtine, Republika e Kosovës ose ne email adresën [hr@kosovotelecom.com](mailto:hr@kosovotelecom.com).

Deklarata nën Betim (te cilën mund ta shkarkoni ne faqen [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)) nënshkruhet ne momentin e dorëzimit te aplikacionit.

Inkurajohen aplikimet nga gratë dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë

**Kandidatët me dokumentacion të mangët, të palexueshëm, të paplotësuar ose jo adekuat do të refuzohen.**

Ky proces rekrutimi mund të monitorohet nga përfaqësues të Projektit Britanik për Emërimet në Pozita të Larta Drejtuese. Kandidatët njoftohen që emrat, rezultatet dhe kualifikimi i kandidatëve me rangimin më të lartë në këtë proces të përzgjedhjes, si të emërueshem, do të publikohen në ueb faqen e projektit. Me të aplikuar për këtë pozitë do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi për publikimin në fjalë. Gjithashtu, do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi që partnerët zbatues nga distanca të kenë qasje dhe përkohësisht, në mënyrë të sigurt të ruajnë informata lidhur me vlerësimin e aplikimit dhe performancës së kandidatëve. Informatat do të fshihen në mënyrë të përhershme pasi që ketë përfunduar vlerësimi.

